

Kërkimi i vendit të mësimit të profesionit- si të bëhët më së miri?

Përcaktimi i profesionit

Nëse shkon të kërkosh një vend për mësimin e profesionit/zejes, duhet që profesioni yt të jetë i përcaktuar. Më fjalë të tjera: ti e di që do të sjellësh aftësitë e tua te nevojshme për profesionin e zgjedhur. Kjo është më rëndësi, dhe të mundëson qëllimisht që të kërkosh në një vend për të cilin je përcaktuar, dhe jo të orientohesh pa planifikuar fare që të hysh, në vendin e parë dhe më të mirin që t'a gjes.

Mbledhja e adresave

Tani ti mund të sjellësh përvoja, se cilat ndërmarrje në profesionin tënd të dëshiruar ofrojnë një vend të lirë për mësimin e profesionit gjatë verës që vjen. Për këtë ti ke mundësi dhe mjete të ndryshme në dispozitim:

- ▶ Në Këshillimorën për Profesione¹ do të gjes lista të ndërmarrjeve të cilat kanë mundësi të shkollojnë nxënësit/et në profesionin e dëshiruar.
- ▶ Në internet janë të dhëna vendet e lira për mësimin e profesionit.²
- ▶ Vende të lira për mësimin e profesionit mund të gjesh në revista falas dhe gazeta ditore si dhe në faqe interneti të ndërmarrjeve të ndryshme.
- ▶ Shumë nxënës dhe nxënëse vijnë deri te një vend i lirë për mësimin e profesionit, përmes të njohurve ose të afërmeve. Shfrytëzoni lidhjet dhe miqësitë e mundshme.

Kontakto

Tani i ke adresat e përshtatshme. Lajmërohu te ndërmarrjet të cilat faktikisht kanë vende të lira. Shfrytëzo për kontakt të parë telefonin, ose shko vetë atje. Pastaj, në rastin e përshtatshëm pyet se si mund të konkurosh. Mënyrat e paraqitjes ndryshojnë nga ndërmarrja në ndërmarrje. Një ndërmarrje e dëshiron një kërkesë me shkrim, ndërsa një tjetër dëshiron që të njoh drejtpërdrejt. Me rëndësi është që të konkurosh ashtu si ata kërkojnë.

Konkuro

Një kërkesë me shkrim heret apo vonë kërkohet nga të gjitha ndërmarrjet. Ka rregulla të qarta, se si duhet të duket një dosje e tillë dhe çka përmban ajo. Nëse ke veshhtësi në përgaditjen e dosjes për konkurim, atëherë mund të marrësh ndihmë në shkollë ose në këshillimorën për profesione.

¹ Secili kanton e ka së paku një Këshillimore për Profesione
Adresat mund të merren në shkollë, në komunën tuaj, apo në internet:

Deutsch: www.adressen.sdbb.ch Français: www.adresses.csfo.ch Italiano: www.indirizzi.csfo.ch

Këshillimorja për Profesione dhe Qendra Informative për Profesione ÇIP
është shpesh e njohur me një emër të veçantë ose me një shkurtesë:

Gjermanisht	BIZ, Laufbahnenzentrum
Frëngjisht	OP, SOPFA, OFPC, COS, OROSP, CIO, OCOSP
Italisht	orientamento, UOSP

² Vende të lira për mësime të profesioneve:

Gjermanisht	www.berufsberatung.ch/Lehrstellen
Frëngjisht	www.orientation.ch/formation
Italisht	orientamento.ch > scelta professionale > Borsa nazionale dei posti di tirocinio

Poashtu në internet mund të gjesh dosje për konkurim.³

E rëndësishme është që dosjën tënde për konkurim para se t'a dërgosh, t'ja tregosh një personi përgjegjës për t'a kontrolluar, sepse ajo duhet të jet e plotë, pa gabime dhe e përshtatshme për profesionin dhe ndërmarrjen.

Ja edhe një këshillë: Mundësisht konkuro në shumë vende njëkohësisht. Kështu do të zmadhosh shanset tua për gjetjen e një vendi për mësimin e profesionit.

Mbaj evidencë

Është e arsyeshme që ta mbash një kontroll mbi të gjitha aktivitetet e konkurremeve të bëra. Më së miri është që për këtë qëllim të bësh një listë, në të cilën do të shënosh së kur ke konkuruar, se a të kanë caktuar ndonjë takim apo deri kur do të informohesh. Kështu ti e din çdo herë se çka është e kryer, prej kujt pret përgjigje dhe kur mund të pyesësh.

Zotëro provimet dhe bisedat

Gjithnjë e më shumë ndërmarrje dhe organizata kërkojnë që të bësh një test të aftësisë. Informohu se si duket ky test në profesionin e dëshiruar dhe çka kërkohet.

Kur të vish deri tek zgjedhja e ngushtë, kryepunëtori/ja do të dëshiroj që të njohë personalisht. Përgatitu me kohë për këtë bisedë prezantuese. Paramendoj pyetjet dhe përgjigjet e mundshme. Nëse je e/i pa sigurt, bisedo me ndokënd. Përshtypja që u mbetet nga kjo bisedë prezantuese, luan një rol shumë më rëndësor. Për këtë paraqitu sa më mirë, tregohu i interesuar dhe i motivuar.

Përballo refuzimet

Situata për kërkimin e vendit për mësim të profesionit në shumë profesione, është e vështirë. Për këtë duhet të llogaritësh edhe me refuzime të kërkesave tua. Mos lejo në asnjë mënyrë që të demoralizohesh. Qendro aty dhe përpiku edhe më tutje. Kërko arsyet e refuzimit. Kështu është e mundshme që në të ardhmen të përmirësosh diçka dhe të rrisësh shanset për sukses.

Bëhu fleksibil

Mos këmbëngul vetëm për një profesion. Ndoshta në profesionin e dëshiruar nuk do të gjesh vend për mësimin e profesionit. Atëherë është më rëndësor që për zgjedhje tjera të jesh i/e hapur.

Nëse përkundër përpjekjeve të mëdha, një kohë të gjatë nuk ke gjetur vend në profesionin e dëshiruar, është e domosdoshme që situatën ta analizosh me kujdes. Kërko mundësitë në ndonjë profesion të përafërt, një vit kalimtar, një praktikë, një vit shkollimi gjuhësor etj. Reago më kohë mbliidh informata ose kërko ndihmë të nevojshme. Bisedo gjithsesi me këshilltarin ose këshilltaren dhe planifiko veprimet e mëtuqjeshme. Përfundimi i një shkollimi themelor profesional (ose një shkolle të mesme) të hap rrugë dhe është një shtyllë e rëndësishme për ardhmerinë tënde. Kështu, ti ke mundësi të ndryshme për zhvillimin tënd të mëtuqjeshëm.

SDBB | CSFO – 2011

³ Gjermanisht www.berufsberatung.ch >Berufswahl >Lehrstellensuche >Bewerbung
Frëngjisht www.orientation.ch >formation >Toutes des places d'apprentissages >Lettre et CV
Italisht orientamento.ch > scelta professionale > Borsa nazionale dei posti di tirocinio
>Consigli per la ricerca

Nga shkolla në profesion

Një njoftim për prindër

Të dashur prindër

Ju keni një djalë apo vajzë në klasën 7, 8, 9 ose 10. Djali/vajza e juaj, duhet të zgjedhë një profesion apo vendosë të vazhdoj një shkollim të mëtutjeshëm. Ky është një hap shumë i rëndësishëm, sepse kryerja e një shkollë të mesme apo e një profesioni/zeje për të rinjtë në Zvicër është një bazë për zhvillimin e tyre të mëtutjeshëm profesional.

Si ndihmon shkolla?

Shkolla përgatitë nxënësit e klasës 8 dhe 9, në zgjedhjen e profesionit apo vazhdimin e një shkollimit të mëtutjeshëm. Pyetni mësuesen ose mësuesin, për shembull në mbrëmje informative për prindër, se si dukët kjo parapërgatitje.

Si ndihmon Këshillimorja për Profesione¹?

Këshillimorja për profesione ju ofron informacione lidhur me profesionet dhe mundësitë e shkollimit të mëtutjeshëm. Zgjedhja e një profesioni është një përçarje personale e domosdoshme, prandaj aty mund të bëhën marveshje për takime bisedash, ku do të diskutohet lidhur me interesat mundësitë dhe aftësitë profesionale. Kjo ofertë për nxënësit dhe nxëneshet është falas dhe e besueshme.

Shkolla dhe këshillimorja për profesione, ndihmojnë të rinjtë në zgjedhjen e një profesioni apo shkollimi të mëtutjeshëm, dhe nëse është e nevojshme edhe gjatë kërkimit të profesionit. Mirëpo, për këtë puna kryesore dhe përgjegjësia i mbetet familjes.

Çka duhet të bëjnë vetë të rinjtë?

Si mund t'ju ndihmoni fëmijëve tuaj?

Djali apo vajza juaj duhet të jetë vetë aktive deri sa ai ose ajo pas mbarimit të shkollës të ketë gjetur një vend për mësim të profesionit. Për shumicën prej tyre kjo nuk është e thjeshtë, atëherë është e nevojshme ndihma e familjes. Nëse keni pyetje dhe nuk dini as vetë si të veproni më tutje, lajmërohuni ju lutëm të këshillimorja për profesione.

Zgjedhja e një profesioni ose vazhdimi i një shkollimi të mëtutjeshëm është një proces (ecuri). Kjo do të thotë të parashtrosh pyetje dhe të kërkosh përgjigje, e për këtë nevojitet kohë. Lidhur me pyetjet më të rëndësishme, rruga më e drejtë për përgjigje të mirëfillta dukët kështu:

A Të njohësh vetëvehtën

Fëmijët e juaj duhet t'ja parashtrojnë vetëvetes këto pyetje:

- Çfarë bëjë unë mirë në shkollë? Cilat lëndë më pëlqejnë mua?

1

Secili kanton e ka së paku nga një Këshillimore për Profesione.

Adresat ju mund t'i merrni në shkollë në komunën tuaj ose në internet:

Deutsch: www.adressen.sdbb.ch Français: www.adresses.csfo.ch Italiano: www.indirizzi.csfo.ch

Këshillimorja për Profesione dhe Qendra Informative për Profesione ÇIP është shpesh e njohur me një emër të veçantë ose me një shkurtesë:

Gjermanisht	BIZ, Laufbahnzentrum
Frëngjisht	OP, SOPFA, OFPC, COS, OROSP, CIO, OCOSP
Italisht	orientamento, UOSP

- Çka kam mësuar në kohën e lirë ose në familje? (P.sh. njohja e gjuhëve të huaja, përgaditja e ushqimit, blerja, riparimimi i gjërave shtëpiake, ndëgjimi me vëmendje i shokëve apo shoqeve të mija kur kanë probleme, jam i kyqur në ndonjë klub sportiv, në ndonjë grup të rinjëve apo ndonjë shoqatë tjetër, ku me rastin e festave bashkëpunoj dhe ndihmoj).
- A kam dëshmuar në ndonjë punë tjetër përpikmerinë dhe besueshmerinë time? (P.sh. në shpërndarjen e gazetave, përkujdesjen e fëmijëve, kositjen e barit në kopsht apo kam ndihmuar në vendpunimin javor 2-3 orësh të ndonjë ndërmarrje).
- Ku qendrojnë aftësitë e mija? Ku qendrojnë dobësitë e mija?

Ju si prindër mund të ofroni ndihmën në vijim:

- Përkrani bijët apo bijat tuaja në mendimin e tyre, ashtu që ata të marrin në konsideratë aftësitë e përparsitë në veprimtaritë, të cilat j'u shkojnë atyre.

B Të njohësh profesionet

Përmes informacioneve dhe "Schnupperlehren"² fëmijët tuaj njihen me profesionet

- Të informohesh do të thotë: të lexosh rreth përshkrimit të profesioneve, të shikosh filma për profesione, të shkosh në "Informationsanlässe"³ dhe "Ausstellungen über Berufe"⁴ e shkollime tjera, dhe të sqarosh pyetjet në këshillimorën për profesione.
- Të bëshë „Schnupperlehre“. Në afatin prej 2 deri 3 ditësh të kësaj „Schnupperlehre“ në profesion, të rinjtë kanë mundësinë që të njohohen më mirë me një profesion në një ndërmarrje. Gjatë kësaj kohe të „Schnupperlehre“, ndërmarrja e bënë verifikimin e të rinjve: përgjegjësit apo përgjegjëset e këtyre ndërmarrjeve, dëshirojnë që t'i njohin të rinjtë më mirë. Kandidatët të cilët u kanë lënë atyre përshtypje të mira, do të kenë shanse më të mëdha pranimi për një vend shkollimi në ndërmarrjen përkatëse.

Çfar ndihme mund të ofroni ju si prindër?

- Shkoni me vajzat apo djemt tuaj, simbas mundësisë në organizimet informative. Ndhmoni ata aktivisht që të mendojnë për këto takime informuese.
- Shoqeroni djemt apo vajzat tuaja në këshillimorën për profesione. Informohuni edhe ju vetë për mundësitë e shkollimit në Zvicër.
- Bisedoni me bijat/bijët tuaj mbi përvojën e bërë gjatë nihatjes në profesion.

² Nuhatje/gjurmim në profesion.

Gjermanisht	Schnupperlehre
Frëngjisht	stage d'information professionnelle; stage en entreprises
Italisht	stages

³ Më rastin e mbledhjeve informative:

Gjermanisht	www.berufsberatung.ch >Berufswahl >Informationsveranstaltungen
Frëngjisht	Për ofertat aktuale, shtroni pyetje në shkollë ose në këshillimorën për profesione.
Italisht	

⁴ Ekspozita për arsimim dhe profesione

Shtroni pyetje të këshillimorja për profesione ose në shkollë, se kur dhe ku gjindet ekspozita mbi profesionet. Këto ekspozita janë të përshkruara me emërtime të ndryshme si:

Gjermanisht	Berufsmesse, Ausbildungsmesse, Berufsschau
Frëngjisht	Salon des métiers, Cité des métiers, salon de la formation
Italisht	ESPOProfessionisti

C Zgjedhja e shkollës dhe profesionit

Gjatë procesit të zgjedhjes së profesionit, fëmijët tuaj duhet të vrojtojnë si vijon:

- Zgjedhja e një shkollimit të mëtutjeshëm apo profesioni kërkon kohë për të menduar dhe kohë për të ndërmarrë gjëra të ndryshme.
- Gjatë zgjedhjes së profesionit të dëshiruar ose të një arsimimi të mëtutjeshëm është shumë më rëndësi të kesh edhe 1 ose 2 shanse tjera rezervë.
- Të bisedoj me mësuesen/mësuesin: „Ku janë dobësitë e mija“? Si mund të përgaditëm unë në shkollë për arsimim pas klasës së 9 ose 10-të?

Çfarë përkrahje mund t'ju ofroni fëmijëve tuaj si prindër?

- Interesohuni për këtë proces vendimtar.
- Bisedoni me fëmijët tuaj për profesionin e zgjedhur dhe shanset e tyre.

D Kërkimi i një vendmësimi (simbas rregullores, një vit pas mbarimit të shkollës)

Për kërkim të një vendshkollimi birin/bijën tuaj mund t'a ndihmoj më tutje broshura vijuese:

- „Kërkimi i vendit të mësimit të profesionit- si të bëhet më së miri“⁵

Çfarë ndihme mund t'ju ofroni fëmijëve tuaj si prindër?

- Përkrahni vajzën apo djalin tuaj që të mendojë e të fillojë me kohë kërkimin e një vendmësimi.
- Jepni kurajo djalit apo vajzës suaj pas zhgënimëve të mundshme, ashtuqë të vazhdojnë më kërkime të mëtutjeshme.

Nga këta shembuj, ju nxirri përvojë se si mund të ndihmojnë nëna dhe babai.

Të bisedohet me mësues

Laura është në klasën e 8. Ajo nuk bisedon fare në shtëpi, në lidhje me zgjedhjen e profesionit apo të shkollimit të mëtutjeshëm. „Ç'po ndodhë“, pyesin prindërit. Nëna shkon në shkollë, mbas mësimit dhe e pyet mësuesin, mos Laura edhe në shkollë nuk tregon interesim për zgjedhjen e ndonjë profesioni apo shkolle.

Të jeni të hapur për mundësi të ndryshme

Nikolasi shkon në klasë e 9. Si shumë të rinj edhe ai dëshiron të mësojë informatikën. Ai kërkon vend për mësim të zejes në këtë drejtim, mirëpo çdo herë merr përgjigje negative. Në mbledhje prindësh, prindërit e kuptojnë se për informatikë ka vetëm pak vende për mësim të këtij profesioni. Ata e udhëzojnë Nikolasin që të lajmërohet në këshillimoren për profesione për një bisedë personale. Nikolasi kthehet me një ide të re në shtëpi: Meqenëse ai është i mirë në matematikë dhe i intereson teknika, tani kërkon një vend për mësimin e profesionit si polimekanik (mekanikë e përgjithshme). Ai e di që në këtë profesion ka të bëjë gjithashtu më kompjuter. Nëse ai dëshiron, pas përfundimit të këtij profesioni, ka mundësi të specializoj informatikën.

Familja është në pritje

„Kur do ti filloj Ahmedi studimet?“ pyesin në shtëpi të afërmit nga fshati. „Në Zvicër është krejt ndryshe nga ajo që ju mendoni“ thonë prindërit e tij. „Ahmedi ka duar të shkathëta dhe i do automjetet. Ai do të bëhet automekanik. Sepse, ai është shumë i mirë në shkollë, dhe kështu ai do t'a bëjë një shkollim profesional katëvjeçar, i cili është shumë i kërkuar. Ky profesion i përgjigjet atij, dhe është një shkollim i mirë. Ne jemi krenar për djalin tonë, që ka arritë kaq shumë.“

⁵ www.berufsberatung.ch >Berufswahl >Information für Fremdsprachige
www.orientation.ch >Choix professionnelle >Informations en langues étrangères
www.orientamento.ch >Scelta professionale >Informazioni per persone di lingua straniera

Më në fund nuk është e lehtë, kur dikush e kryen shkollën në gjuhë të huaj“. Si automekanik Ahmedi mund të gjejë punë në mbarë botën!

Mungesa e njohurive gjuhësore

Fatma është një vajzë shumë e zgjuar. Ajo kishte ardhur në Zvicër në moshën 15 vjeçe, dhe ende nuk ka mjaft njohuri të gjuhës që kërkon një arsimim i lartë. Fatma dhe prindërit e saj njoftohen se pas mbarimit të shkollës së detyruar, ajo mund të bëjë një vit shkollë për përgatitje profesionale, një mësim të ulët profesional ose një shkollim të përgjithshëm profesional 2 vjeçar. Për Fatmen dhe familjen e saj e gjithë kjo procedurë është e panjohur. Në të vërtetë, ata duhet që së pari t'i njohin mundësitë. Fatma është gjithashtu e zhgënjyer. Ajo kishte ëndërruar gjimnazin...Prindërit e ngushëllonin atë: „Ty të duhet ndoshta kohë më shumë se sa të tjerëve. Nëse i plotëson zbrazëtirat tua, ti do të bësh një shkollim themelor profesional, i cili është shumë i kërkuar, dhe ndoshta më vonë do të studiosh. Ti do ta arrish këtë!“

Profesioni ose martesë?

Samira do t'i mbushë së shpejti 16 vjet. Një djalë i ri vjen për vizitë në shtëpi. Ai e pyet babain e Samirës: „A mund të martohem me Samirën?“ Babai i përgjigjet: „Ne dhe ju si familje kemi raporte të mira dhe tradita të njëjta, ashtuqë martesë e Samires me ty do të përshtatej. Mirëpo ti e din se ne jetojmë në Zvicër, jeta ndryshon. Këtu është shumë me rëndësi që gratë dhe burrat të kenë një profesion. Për këtë arsye Samira duhet që së pari të mësoj një profesion. Më vonë ajo mund të vendosë vetë se a dëshiron të martohet.“

Babai e shoqëron djalin e tij

Leonardo është në vitin e fundit të shkollës. Mësimi në shkollë nuk i vjen edhe aq i lehtë. Ai ka gjetur një vend, që të bëjë një nuhatje në profesionin e zdrukthëtarisë. Ai e din se për zejen e zdrukthëtarit duhet t'a bëjë shkollimin e përgjithshëm profesional 2 vjeçar. Nëse nuhatja shkon si duhet. Për këtë nuhatje të profesionit, Leonardo është i shqetësuar dhe ndihet i pa sigurtë, sepse nuk e njeh mirë rrugën dhe do që të jetë i përpiktë. Babai i jap atij guxim: „Ti din shumë për këtë profesion. Përpiqu vetë. Ditën e parë do të përcjell deri tek dera e ndërmarrjes. Ne do të nisemi me kohë nga shtëpia, nëse na mjafton koha do të bëjmë një shetitje të vogël. Kjo e ndihmon njeriun, ku ai është i shqetësuar.“

Shfrytëzoni lidhjet - miqësitë

Paula është një nxënëse e mirë. Ajo ka nota të mira në frëngjisht, gjermanisht dhe matematikë. Përpos këtyre ajo di të flas, të shkruaj dhe të lexoj portugalisht. Asaj i interesojnë shumë profesione, merr pjesë në shumë organizime informative dhe bënë nuhatje nëpër profesione. Tashmë është e qartë, ajo dëshiron të bëjë shkollën e tregtisë. Paula konkurren në shumë vende, por merr vetëm përgjigje negative. Babai i saj punon në ndërtimtari, dhe i tregon shefit, se vajza e tij kërkon një vend të mësimin të profesionit. „Pyet tek ne në zyrë, ata shkollojnë gjithashtu nxënës“, mendon shefi. „Këtë do ta bëjë unë, poashtu gruaja ime mund të pyes në spitalin ku ajo punon. „Athua kemi ne ndonjë fqinjë që mund të na ndihmonte?“ , mendon babai.

Mos u dorzo

Mehmetit i ka arritur prap një përgjigje negative pas konkurimit si shitës. Tash e disa her ai ka dërguar shumë kërkesa, por thjesht nuk ka patur sukses. Mehmeti harron bukur shpesh që të kërkoj dhe të dërgoj shkresa për vendet e lira. Ai e ka humbur disi guximin. Gjatë një darke së bashku mendonin prindërit: „ne do të shkojmë së bashku në këshillimorën për profesione. Atje do të informohemi se çka duhet të ndërmarrësh ti dhe çfar ndihme të ofrohet aty. Mos u dorzo. Ti do të arrish diçka. Ne të përkrahim dhe të shoqrojmë ty.“

Të dashur prindër!

Në qoftë se keni pyetje në lidhje me profesionin e vajzës apo djalit tuaj, mos pritni. Pyetni mësuesin, mësuesen ose në këshillimorën për profesione.

SDBB | CSFO – 2011

Rrugët deri të punësimit dhe shkollimi në Zvicër

Njoftim për të rritur

A e keni kryer një shkollë në vendin tuaj dhe a jeni duke kërkuar punë në Zvicër? Apo ndoshta dëshironi që në Zvicër të shkolloheni më tutje? Në këtë listë ju mund të gjeni disa informata të rëndësishme, të cilat, si hapa të parë, do t'ju ndihmojnë gjatë kërkimit të punës apo shkollimit të mëtutjeshëm.

„Parlez-vous français?“ „Sprechen Sie Deutsch?“ „Parla italiano?“

Pavarësisht a jeni duke kërkuar punë apo ndoshta dëshironi ta kryeni një shkollim: njëra nga parakushtet më të rëndësishme është njohja e gjuhës përkatëse të vendit.¹ Nëse ju jetoni në vendin ku flitet gjermanishtja: filloni ta mësoni gjuhën letrare gjermane! Kështu fitoni një bazë të mirë, që më vonë do ta kuptoni gjermanishten e Zvicrës apo ndoshta edhe ta flisni. Për një ndihmës punëtor edhe mund të mjaftoj nëse kupton dhe din pakëz të flas njërin nga gjuhët përkatëse të vendit. Mirëpo, nga punëtorët, për herë e më shumë po kërkohet që deri diku të dinë ta lexojnë dhe ta shkruajnë një gjuhë. Ndërsa për një punë më kërkesa të larta, gjuhën duhet ta njohin dukshëm më mirë. Për një shkollim të mëtutjeshëm apo për të studiuar, kërkohet që tekstet e vështira t'i lexojnë, t'i kuptojnë dhe të dinë t'i shkruajnë: varësisht nga qëllimi i shkollimit të tyre, ata duhet të arrijnë nivelin e duhur të njohjes së gjuhës. Për këtë arsye është e rëndësishme që të njoftoheni mirë, se cilat kurse të gjuhës janë të nevojshme për qëllimin e juaj.

Përveç kësaj, gjuha nuk është e rëndësishme vetëm për punësim apo shkollim të mëtutjeshëm në Zvicër. Njohja e gjuhës ju nevojitet edhe në situata tjera të jetës: të komunikoni me fqinj, të bëni blerje, të dini të komunikoni me mësuesin e fëmijës tuaj, apo me mjekun; të bëni plotësimin e formularëve, të dini të komunikoni me institucionet etj. Në qoftë se në vitet e ardhshme dëshironi (ose duhet) të punoni, ju, duke e mësuar gjuhën, keni bërë hapin e parë, më të rëndësishëm!

Njoftime mbi kurset e gjuhëve, ju mund të gjeni edhe në internet.² Ndërsa, njoftime të tjera për kurset e gjuhëve, mund t'i merrni edhe në Këshillimoren për Profesione, të cilat janë në faqen e fundit të këtij njoftimi.

Këshillë për kërkim të vendit të punës

Për kërkimin e vendit të punës rol shumë të madh luan njohja e gjuhës, shkollimi paraprak, përvoja profesionale dhe lejeqëndrimi. Poashtu gjendja ekonomike në Zvicër, mund të sjellë vështirësi për ta gjetur një vend pune, posaçërisht nëse ju nuk keni punuar asnjëherë më parë në këtë shtet. Shfrytëzoni në ç'do rast që në Zvicër të fitoni përvojë pune: për shembull ta bëni një praktikë, apo ndonjë punë, edhe pse niveli i shkollimit tuaj është më i lartë. Ndoshta më vonë do ta fitoni një vend pune më të mirë, po në të njëjtën ndërmarrje, apo duke ju falënderuar praktikës së bërë, ju mund ta merrni një certifikatë të mirë pune, me të cilën do të keni gjasa më të mira në konkurimet e tjera! Poashtu edhe puna vullnetare mund të jetë një rast i mirë që të fitoni përvojë dhe të njiheni me njerëz të cilët ndoshta mund t'ju ndihmojnë për të gjetur një vend pune.

Tregojuni të afërmve tuaj, shokëve dhe miqve, që jeni duke kërkuar punë. Ndoshta në ndërmarrjet e tyre, befaz mund të ketë një vend të lirë? Apo ndoshta këta shokë njohin ndokënd që dinë për ndonjë ndonjë vend të lirë?

¹ Zvicra ka katër gjuhë zyrtare: gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe gjuhën retoromane (Rumantsch grischun)

² Kurse për gjuhë në internet: Gjermanisht: www.berufsberatung.ch/weiterbildung
Frëngjisht: www.orientation.ch/perfectionnement
Italisht: www.orientamento.ch/perfezionamento

Një vend të punës në Zvicër mund ta gjeni përmes shpalljeve, gazetave internetit dhe kontaktit direkt ne ndonjë ndermarrje. Përveq kësaj për vendkërkimin e punës mund t'ju ndihmoj edhe qendra regionale ndermjetsuese e entit për punësim³.

Njohja- verifikimi i diplomave të huaja

A keni mbaruar në vendin tuaj një shkollim me diplomë, keni marrë një certifikatë apo një dëftesë? Ju keni mundësinë që ta testoni se cilën “vlerë” e ka diploma e juaj në Zvicër.

Për ushtrimin e profesionit me diplomën, të cilën e pranon shteti, atëherë është e nevojshme një njohje-verifikim i kësaj diplome. Te profesionet tjera, të cilat nuk i njih shteti, qendra kontaktuese shtetore propozon një vërtetim të nivelit tuaj, kështu që, për të punuar në Zvicër nuk ju nevojitet njohja e diplomës së vendit tuaj. Nëse një konkruuese ose konkruesi i kërkohet shkollimi përkatës, e tëra kjo mvarret nga tregu i punës dhe nga punëdhënësi ose punëdhënësja. Te vërtetimi i një niveli profesional, është fjala për vërtetimin e lëshuar nga Zyra Shtetore për Shkollim Profesional dhe Teknologjik (BBT) dhe shkolla, të cilat i informojnë punëtorët e ardhshëm dhe autoritetet lokale për kategorizimin e diplomës së huaj, përkatësisht dëftesës sipas sistemit shkollor zviceran. Për fat të keq, kjo diplomë nuk u garanton se do të gjeni punë në profesionin tuaj, posaçërisht nëse ju mungon përvoja profesionale në Zvicër.

Mirëpo, ajo është një hap i rëndësishëm në këtë drejtim. Dhe ndoshta mund ta vazhdoni një shkollim të mëtutjeshëm, i cili do t'ju ndihmoj dhe përgatitë për kryerjen e diplomës në Zvicër.

Drejtohuni në zyrën kontaktuese të shtetit⁴ këtu do të mësoni, se si duhet vepruar.

Shkollimi – sistemi i arsimimit profesional në Zvicër

Në Zvicër rruga deri te një profesion i caktuar duket krejt ndryshe nga ajo e vendit tuaj. Kështu që, këtu vetëm për numër të vogël të profesioneve duhet bërë shkollën e mesme pastaj Universitetin.

Pjesa dërmuese e të rinjve zviceran, mbas shkollimit të detyruar, e mësojnë një profesion në një shkollë profesionale: Gjatë tri deri katër vite shkollimi, ata bëjnë në njërin anë praktikën në një ndermarrje, por njëkohësisht vazhdojnë në një shkollë për mësimin teorik.

Zvicra ka 250 profesione të cilat mund të mësohen mbas kryerjes së shkollimit të detyruar.

Mbas përfundimit të këtij shkollimi profesional, për secilin profesion ekzistojnë kurse të llojllojshme dhe mundësi të ndryshme shkollimi të mëtutjeshëm. Informohuni se cila rrugë e shkollimit në Zvicër, ju drejton në profesionin tuaj. Kështu do të keni njohuri se cilat mundësi i keni për shkollimin të mëtejshëm por gjithashtu edhe në cilën profesion mund të kërkoni të shkolloheni. Në broshurën “Çka pas shkollës?”, jepet një pasqyrë shumë e mirë mbi sistemin e shkollimit në Zvicër. Kjo broshurë gjendet në këshillimoren për profesione, e përkthyer në gjuhë të ndryshme dhe sipas rregullores, mund të shikohet dhe të huazohet.

Marrja e diplomës për të rritur

Për të rriturit, ka mundësi të ndryshme, që të vijë deri te marrja e diplomës. Informohuni në Këshillimoren për profesione.

³ Gjermanisht: Regionales Arbeitsvermittlungszentrum (RAV); www.treffpunkt-arbeit.ch
Frëngjisht: Office régional de placement (ORP); www.espace-emploi.ch
Italisht: Ufficio regionale di collocamento (URC); www.area-lavoro.ch

⁴ Gjermanisht: www.sbf.admin.ch > Deutsch >Anerkennung ausländischer Diplome
Frëngjisht: www.sbf.admin.ch > Français >Reconnaissance de diplômes étrangers
Italisht: www.sbf.admin.ch >Italiano >Riconoscimento dei diplomi esteri
Anglisht: www.sbf.admin.ch > English >Recognition of foreign qualifications

Financimi i një studimi apo shkollimit të mëtutjeshëm

Në qoftë se jeni të interesuar të kryeni një shkollim të mëtutjeshëm apo të studioni, ju duhet të mendoni edhe për financim! Shumica e studentëve në Zvicër janë të ndihmuar nga prindërit, apo krahas studimeve punojnë dhe kështu financojnë shkollimin e mëtutjeshëm apo studimet e veta.

Vetëm me kushte të caktuara, është e mundshme që të fitohet bursa.⁵

Oferta të ndryshme të Këshillimorës për Profesione⁶

Nëse doni të informoheni për rrugën e shkollimit, dhe nëse vërtetë mendoni ta ndërtoni ardhmërinë tuaj profesionale në Zvicër, shkoni dhe vizitoni këshillimorën për profesione.

Në këshillimorën për profesione, ju mund të gjeni informata për të gjitha shkollimet dhe profesionet, aty ka edhe një infotekë. Infoteka funksionon sikurse biblioteka. Në këshillimore keni mundësinë të shkoni gjatë orarit të punës pa paralajmërim, atje informoheni për profesione dhe mundësi të ndryshme të shkollimit dhe mund të huazoni material për informim. Në infotekë gjeni fletushka dhe dokumentacione në lidhje me tema të ndryshme, për shembull adresat e këshillimoreve në regjionin tuaj. Këto dokumentacione mund të merren në gjuhë përkatëse të vendit. Vetëm një numër i vogël prej këtyre informacioneve, janë të përkthyer në gjuhë të tjera!

Në rast se nuk dini të gjendeni vetëm në infotekë, mund të kërkonti që ta keni një këshillim personal me një person kompetent dhe të bisedoni në lidhje me situatën tuaj profesionale (lajmërohu në infotekë ose me telefon).

Kjo bisedë do të drejtohet në gjuhën përkatëse vendore. (për gjuhë tjera simbas kërkesave). Këshillimorja për profesione nuk ndërmjetëson për vende pune, mirëpo aty ju mund të bisedoni me këshilltaren/in në lidhje me mundësitë profesionale, ose kërkimin e ideve të reja apo së bashku të planifikoni një rrugë të drejt për punë ose shkollim.

Rruga drejt shkollimit dhe punësimit në Zvicër, kërkon prej jush shumë durim dhe kohë!

Në këtë drejtim, ju urojmë shumë sukses dhe çdo të mirë.

SDBB | CSFO – 2011

⁵ Informacione lidhur me bursat te Këshillimorja për Profesione ose në internet:

Gjermanisht: berufsberatung.ch >Laufbahn >Tipps für die Laufbahnplanung >Finanzierung der Weiterbildung
Frëngjisht: orientation.ch >Formation >Financer sa formation
Italisht: orientamento.ch >Formazioni >Finanzare la propria formazione

⁶ Secili kanton e ka së paku një Këshillimore për Profesione

Adresat mund të merren në shkollë, në komunën tuaj, apo në internet:

Gjermanisht: www.adressen.sdbb.ch Frëngjisht: www.adresses.csfo.ch Italisht: www.indirizzi.csfo.ch

Këshillimorja për Profesione dhe Qendra Informative për Profesione ÇIP është shpesh e njohur me një emër të veçantë ose me një shkurtesë:

Gjermanisht: BIZ, Laufbahnzentrum
Frëngjisht: OP, SOPFA, OFPC, COS, OROSP, CIO, OCOSP
Italisht: orientamento, UOSP